



KOLEGJI ESLG

PROCESVERBALI I TAKIMIT TË SENATIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi 3 pika 12 e Statutit të Kolegjit ESLG dhe në bazë të nenit 2 të Rregullores mbi procedurën e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të Kolegjit ESLG, Senati i Kolegjit ESLG në mbledhjen e mbajtur me korrespondencë më 06.10.2021 aprovoi si në vijim:

- Emërimin e Grupit Punues për përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit dhe kryerjes së procedurës së vetëvlerësimit për ri-akreditimin institucional të Kolegjit ESLG si në vijim:
 - Prof. Dr. Visar Hoxha, Prof. Asistent Dr. Islam Hasani, Profesor Asistent Dr. Hazer Dana, Profesor Asistent Dr. Veli Lecaj, M.Sc. Jehona Hoxha (Zyra e Cilësisë), dhe Viola Brahushi (përfaqësues e studentëve);

Neni 22 paragrafi 3 dhe pika 12 e Statutit të Kolegjit ESLG i cili parashikon kompetencat e senatit thote se Senati emeron organet e punës për kryeljen e punëve në fushat e caktuara.

Gjithashtu neni 2 i Rregullores mbi Procedurën e Vetëvlerësimit dhe vlerësimit të Kolegjit ESLG parashikon se pas propozimit të rektorit, Senati në mbledhjen e vet cakton ekipin e vetëvlerësimit për programe studimore e cila përbehet nga me se paku tre anëtarë.

Anëtarët e caktuar nga Senati i Kolegjit ESLG janë drejtorë të programeve studimore, përfaqësues të stafit akademik, përfaqësues të studentëve dhe zyrës së cilësisë së Kolegjit ESLG.

Anëtarët e Grupit Punues për Vetëvlerësim gjatë procedurës së vetëvlerësimit janë të obliguar të konsultojnë Klubin Alumni për të pranuar komentet dhe reagimet e të diplomuarve dhe me Këshillin Industrial Institucional për të pranuar komentet dhe reagimet e industrisë mbi aspektet e caktuara.



KOLEGJI ESLG

Anëtarët e Senatit:

Prof. Dr. Visar Hoxha

Prof. Asistent Dr. Veli Lecaj

Prof. Asistent Dr. Islam Hasani

Prof. Asistent Dr. Mersiha Kacamakovic

M.Sc. Jehona Hoxha

Prof. Asistent. Dr. Hazer Dana

Viola Brahushi, Përfaqësuese e studentëve

Blerta Nahi Demjaha, Përfaqësuese

M.Sc. Elita Çeku